

**STATUTI**  
I  
**SHOQËRISË TREGTARE “NALTA” SH.P.K.**

**Akt Themelimi**

Sot, më datë 01/10/2019 (dymijë e nentembëdhjetë), ortakët themelues:

- Znj. Ermira Derri , shtetas shqiptar, i lindur në Krume, Has, më 15/07/1993, banues në, Has, Rruga “**Gjakova**”, Godina “Liqeni” katër 2, Lagjia Fushe Plan, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr personal J35715038T.

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare “**NALTA**” Shpk., rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, (në vijim Shoqëria).

**NENI 1.**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktivitetave tregtare neperputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi. Ne menyre mespecifike, Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te jetë agroturizmi, ne perputhje me VKM nr. 22, date 12.01.2018, ofrimi e sherbimeve akomoduese, restorative dhe rekreative te lidhura me fermen. Perpunimin e produkteve bujqesore, blegtoriale, te cilat jane te pershtatshme per zhvillimin e veprimtarive te agroturizmit Blerja, marrja me qira, administrim i arave, tokave te mbjella me kultura bujqesore. Manaxhim i fermave blegtoriale, staneve etj. Sherbim ushqimi, restorant, import-eksport, veprimtari ne fushen e hoteleri –turizmit. Shoqeria do te mund te kryeje çdo aktivitet te ligjshem tregtar import, eksporti, tregtia me shumice e pakice te mallrave, çdo aktivitet qe lidhet me çfarendojoj pasurie te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne blerjen, shitjen, transferimin, ndertimin, nen-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhenin me qira, leasing e pasurive te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, dhenien e fitimin e çdo te drejte apo privilegji ne lidhje me keto pasuri. Shoqeria mund te kryeje aktivitetit publikimi dhe reklamimi. Gjithashtu shoqeria do te kryeje çdo lloj aktiviteti tjeter siç mund te konsiderohet i nevojshem apo i dobishem apo ndihmes ne permbushjen e qellimeve te mesiperme.

Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

**NENI 2**

**Emri dhe selia e Shoqërisë**



Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "NALTA" Shpk.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga Gjakova, Godina "Liqeni ", kati 3,Has, Shqipëri.

#### NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i pa afat.

#### NENI 4.

Regjimi juridik i Shoqërsë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtronhet dispozitave të Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

#### NENI 5.

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhin në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

#### NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortakët japid kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do t'u përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.



Gjatë ushtrimit të tē drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gjëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Statuti. Ata përpiken për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

#### NENI 7.

##### Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtonë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

#### NENI 8.

##### Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund tē mbajnë një pozicion drejtues apo tē jenë tē punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në tē njëtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund tē mbajnë statusin e tregtarit për tē ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendur më sipër mund tē ndryshohet apo shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me 51% të votave të ortakëve të pranishëm.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në tē, por jo për një periudhë më tē gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) tē kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) tē ngrejë padi për shpérblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritisë së padisë për shpérblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

1. tē pranojë që transaksionet e kryera për llogari tē tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
2. t'i transferojë shoqërisë tē gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari tē personave të tretë;
3. t'i transferojë shoqërisë tē gjitha tē drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari tē personave të tretë.

#### NENI 9.

##### Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortaku mund tē largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm tē tij, nëse është penguar tē ushtrojë tē drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime tē paarsyeshme apo për shkaqe tē tjera, që e bëjnë tē pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet tē njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe tē parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet



të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

#### **NENI 10.**

##### **Përjashtimi i ortakut**

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to , rastet kur ortaku:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë përsigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërcohët të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndaj tij padi për shpérblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**

##### **NENI 11.**

Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë e të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

##### **NENI 12.**

Kapitali fillestar i investuar nga Ortaket, perben bazen e krijimit te fondit themeltar te mjeteve te xhiros. Administratori i dorezon Ortakeve dokumentin vertetues per sasite e shumave te derdhura ne fazen e themelimit.

Vleresimi i kapitalit ne natyre eshte bere nga Ortaket Themelues ne momentin e themelimit te Shoqerise.

Ortaket mund te kryejne ne baze te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, financime per llogari te shoqerise ne perpjersetim me kuotat e zoteruara ne kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe per financime jo fitimprurese.

#### **NENI 13.**

##### **Kapitali i Shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i ortakeve themelues. Ai perbehet nga 1 ( nje ) kuote. Kontributi ne para per 1 (nje) kuote do te kete vleren prej 200,000 (dyqindmije) Leke.

Ortaket themelues do te zoterojne kuotat ne Shoqerine "**NALTA**" Shpk., si me poshte:

- Z. Ermira Derri ne cilesine e Ortakut themelues zoteron 1 (nje) kuote me vlore sa 100 % e kapitalit te shoqerise.

Kapitali themeltar eshte derdhur ne total nga ortaket themelues ne diten e sotme. Vleresimi dhe pagesa e kapitalit themeltar eshte kryer nga ortaket me miratimin e ketij Akti.

#### **NENI 14.**

##### **Pronesa mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nepermjet:

kontributit ne kapitalin e shoqerise; shit-blerjes; trashegimise; dhurimit;

ne cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

#### **NENI 15.**

##### **Miratimi i Asamblese se Pergjithshme per fitimin apo kalimin e kuotave.**

Pavaresisht nga menyra e fitimit apo kalimit te kuotave, eshte i nevojshem miratimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne cdo rast, ortaket e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes. Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen sipas ligjit, ndryshe jane te pavlefshme.

#### **NENI 16.**

Kuotat mund te anullohen ne cdo rast me miratimin e ortakut perkates dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes, shuhen me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit të kuotës do të përcaktohen nga rregullore të posaçme, të miratuar nga Asambleja e Ortakëve me 51% të votave të ortakëve të pranishëm.

Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktiveve të nenit 9 të këtij statuti.

#### **NENI 17.**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve të pranishëm.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

#### **NENI 18.**

##### **Fondet rezerve**

Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimitarisë së saj.

#### **NENI 19.**

##### **Përdorimi i të ardhurave neto**

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

#### **NENI 20.**

##### **Bilanci, plani finanziar.**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

#### **NENI 21.**

##### **Shpërndarja e fitimeve**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

#### **NENI 22.**

## Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## IV. ORGANET E SHOQËRISË.

### NENI 23.

#### Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve të pranishëm në rastet e mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve;
- raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.



#### **NENI 24.**

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asamblea e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### **NENI 25.**

##### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 26.**

##### **Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% për qind të kapitali. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.



Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

#### NENI 27.

##### Proçesverbali i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Proçesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Proçesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

#### NENI 28.

##### Hetimet e posaçmë

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçmës për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kerkuar hetim të posaçmës, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit apo statutit.

Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të procedojnë vetë përpara gjykatës brënda 30 ditëve nga refuzimi i asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asamblea e Përgjithshme nuk merr një vendim brënda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfqësues I posaçëm I shoqërisë I emëruar nga Asamblea e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpermendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyhsime në lidhje me të përfaqësimin e tij jo në interes të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

## V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 29.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të caktojë rregulla të posacme për emërimin e administratorëve.

Administrator te Shoqërisë emërohen :

- Znj. Ermira Derri , shtetas shqiptar, i lindur në Krume, Has, më 15/07/1993, banues në Krume, Has, Rruga "Gjakova", Godina "Liqeni" kat 2, Lagjia Fushe Plan, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr personal J35715038T.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratorët e shoqërisë, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### NENI 30.

#### Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratorët kanë të drejtë e detyrime të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



7. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpérblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **NENI 31.**

##### **Shpérblimi i administratorëve**

Shpérblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të janë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpérblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpérblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendojë reduktimin e shpérblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpérblimit, shpérblimi individual dhe efekti vjetor i shpérblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

#### **NENI 32**

##### **Ekspertët Kontabël**

Shoqëria emëron ekspertin kontabël për një afat një vjecar në rastet e parashikuara nga ligji. Emërimi i tyre bëhet nga Asambleja e Përgjithshme.

Ekspertët kontabël janë përgjegjës për mirëmbajten e dokumentave të shoqërisë.

Ata janë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara që mund të vijnë nga mbajtja e llogarive në mënyrë të parregullit.

Nuk mund të emërohen si ekspertë, themelues, administratorë, persona që kanë lidhje gjaku deri në shkallën e katërt.

#### **VI. MARRDHËNIET E PUNËS.**

##### **NENI 33.**

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Statutit dhe Legjisacionit Shqiptar të Punës.



Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

#### NENI 34.

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

#### VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

##### NENI 35.

Shoqëria prishet në rast kur:

1. kur mbaron kohëzgjatja e themelimit të saj;
2. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
3. në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
4. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
5. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
6. për cdo shkak tjeter të vendosur nga asambleja e ortakëve, etj.;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

##### NENI 36.

###### Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrinin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës



Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

#### NENI 37.

##### Të drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

#### NENI 38.

##### Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### NENI 39.

##### Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

#### NENI 40.

##### Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshtypet, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përparrë gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëni me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

#### VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

##### NENI 41.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

##### NENI 42.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

##### NENI 43.

Ky Statut përpilohet në 3 kopie të njëjtë në gjuhën shqipe, me nga 14 ( 1-14) fletë secila kopje e pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES :

Ermira Derri

